Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Titulli i lëndës:	**Bazat e Dizajnit**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**1**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**6**
Përshkrimi i lëndës	Lënda ofron njohuri mbi elementet dhe parimet themelore të dizajnit grafik, si pika, vija, forma, ngjyra, tekstura dhe tipografia, si dhe ekuilibri, kontrasti, ritmi dhe hierarkia vizuale. Përmes analizave dhe ushtrimeve praktike, studentët aplikojnë këto njohuri në krijimin e posterëve, kartvizitave, katalogëve, broshurave dhe materialeve të tjera grafike. Lënda trajton gjithashtu konceptet bazë të markës dhe logos, teorinë e Gestalt-it, modularitetin dhe proceset bazë të shtypit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i lëndës është t'u ofrojë studentëve njohuritë dhe aftësitë bazë në dizajnin grafik, duke zhvilluar të kuptuarit e elementeve dhe parimeve të dizajnit, kreativitetin dhe aftësinë për komunikim vizual. Përmes punës praktike, studentët aftësohen të zbatojnë këto njohuri në krijimin dhe zhvillimin e projekteve të ndryshme grafike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: • Identifikojnë dhe shpjegojnë elementet dhe parimet themelore të dizajnit grafik. • Zbatojnë ngjyrën, tipografinë, kontrastin, hierarkinë dhe kompozicionin në komunikimin vizual. • Zbatojnë parimet e dizajnit grafik në realizimin e projekteve praktike. • Zhvillojnë koncepte bazë për markë, logo dhe materiale promovuese. • Analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike punimet e dizajnit grafik.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	12	24
Punë praktike	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren	2	1	2
Kollokfiume,seminare	2	1	2

Detyra të shtëpisë	3	9	27
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	13	26
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	4	8
Projektet,prezentimet ,etj	3	6	18
Totali			150
Metodologjia e mësimëdhënies:	Mësimdhënia realizohet përmes ligjëratave interaktive, demonstrimeve dhe analizës së shembujve vizualë, ushtrimeve praktike, punës individuale dhe grupore, projekteve, prezantimeve dhe kritikës së punimeve.		
Metodat e vlerësimit:	**50%** – Punime dhe projekte praktike gjatë semestrit **20%** – Prezantim, diskutim dhe angazhim gjatë procesit mësimor **30%** – Provim final (praktik dhe/ose teorik, sipas natyrës së lëndës) **Shkalla e notimit (0–100 pikë)** • 0–49 pikë – Notë jo kaluese • 50–59 pikë – Nota 6 • 60–69 pikë – Nota 7 • 70–79 pikë – Nota 8 • 80–89 pikë – Nota 9 • 90–100 pikë – Nota 10		
Literatura			
Literatura bazë:	*Graphic Design: The New Basics Paperback – July 14, 2015 by Ellen Lupton (Author), Jennifer Cole Phillips (Author)*		
Literatura shtesë:	*Design Elements, 2nd Edition: Understanding the rules and knowing when to break them - Updated and Expanded Paperback – May 21, 2014 by Timothy Samara*		

Java	**Ligjerata që do të zhvillohet**
Java e parë:	**Hyrje në dizajnin grafik –** historia, evolucioni dhe roli i dizajnit
Java e dytë:	**Elementet e dizajnit –** pika, vija, forma dhe tekstura
***Java e tretë*:**	**Ngjyra dhe teoria e ngjyrave**
Java e katërt:	**Tipografia –** parimet bazë dhe roli në komunikimin vizual
Java e pestë:	**Parimet e dizajnit –** ekuilibri, kontrasti, harmonia dhe hierarkia

***Java e gjashtë*:**	**Përsëritja, ritmi, hapësira dhe modeli**
Java e shtatë:	**Teoria Gestalt** dhe perceptimi vizual
Java e tetë:	**Marka** dhe identiteti vizual
Java e nëntë:	**Logo** – koncepti dhe zhvillimi
Java e dhjetë:	**Dizajni i posterit**
***Java e njëmbedhjetë*:**	**Kartvizita** dhe materiale të identitetit vizual
***Java e dymbëdhjetë*:**	**Katalogu** dhe **broshura**
***Java e trembëdhjetë*:**	**Ftesa** dhe materiale promovuese
***Java e katërmbëdhjetë*:**	**Modulariteti** dhe sistemet (grid-et) në dizajn
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	Proceset bazë të shtypit dhe përgatitja e projektit përfundimtar
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studentët duhet të jenë të rregullt dhe aktivë në ligjërata dhe ushtrime, të pajisen me mjetet e nevojshme të punës dhe t'i dorëzojnë detyrat brenda afateve të përcaktuara. Respekti ndaj kolegëve dhe mësimdhënësve, komunikimi konstruktiv gjatë kritikës së punimeve dhe respektimi i etikës akademike janë të domosdoshme për një mjedis profesional dhe krijues.	